

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i ish-krerëve të UÇK/ Leka: Duhet ofensivë! Parlamenti i Shqipërisë të miratojë rezolutën për krim et serbe në Kosovë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/denimi-i-ish-krereve-te-uk-leka-duhet-ofensive-parlamenti-i-shqiperise-te-i586673
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:55:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:20:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ef31da4e799fcb5f488461f34391ed33e076932a6af43c43270122d7df6d3984
TEKSTI	df6d7df5a829b63a12d2e4c5f04bcf5ab4238c2d27e2bb660a2faa1fdb0c434
PAMJA	5c5e2817d2e75b79d944db75c3e94880b80c4706ba9748108fb99a0035604ef6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	340fb5db4764eb426e5151bb41b3371821dab0803161233fabcd22df92733980a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/340fb5db4764eb426e5151bb41b3371821dab0803161233fabcd22df92733980a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



le [Plagosen me thike dy vellezer, arrestohen ne flagrante 3 persona Vodhen me dhune Xhiron ditore ne dy pika karburanti/ Shpallet ne kerkim 32-vjecari, vjlon puna per id](#)
fundit

Dënimi i ish-krerëve të UÇK/ Leka: Duhet ofensivë! Parlamenti i Shqipërisë të miratojë rezolutën për krimet serbe në Kosovë



17 Shtator 2026, 14:20Rajoni TEMA



Analisti Martin Leka ka komentuar vendimin e Gjykatës Speciale ndaj Hashim Thaçit dhe ish-krerëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndaj të cilëve u shqiptuan 81 vite burg në total. Ai e cilësoi vendimin si “të padrejtë dhe politik”, duke theksuar se situata duhet të shërbejë si një moment reflektimi për gabimet politike në Kosovë.

Sipas tij, Shqipëria, Kosova dhe faktori shqiptar në rajon duhet të koordinojnë qëndrimet dhe të përdorin diplomacinë për përballimin e situatës. Leka kërkoi gjithashtu një angazhim më të madh diplomatik dhe miratimin e një rezolute për krimet serbe dhe gjenocidin në Kosovë.

Ai kritikoi edhe qëndrimin e qeverisë së Albin Kurtit, e cila siç thotë Leka, gjatë periudhës së paraburgimit dhe gjykitimit të ish-krerëve të UÇK-së nuk ka mbajtur qëndrimet e duhura.

Sipas analistit, ka ardhur koha që Parlamenti i Shqipërisë do duhet të miratojë një rezolutë, e cila dënon krimet dhe gjenocidin serb në Kosovë.

Gjatë diskutimit, Leka theksoi se krahas rezolutës, Shqipëria duhet të akordojë një fond të posaçëm në mbështetje të katër ish-udhëheqësve të UÇK-së, në betejën e tyre për të kërkuar pafajësi në Apel.

“Është një vendim totalisht i padrejtë, vendim politik, është një burgosje që u bëhet Hashim Thaçit dhe ish-krerëve të tjetër të UÇK, është një trup historik, për ata që iniciuan dhe detyron Kuvendin e Kosovës për të votuar atë Gjykatë.

Një dënim, i cili do duhet ta themi, se duhet që të mos na dekurajojë për të mësuar nga gabimet politike, sidomos të republikës së Kosovës, sepse për hir të së vërtetës, duhen të vëmë në lëvizje të gjitha aftësitë tona të dijes dhe të diplomacisë për të pasur një qëndrim unik të të gjithë faktorit shqiptar në tre shtete që janë në Ballkan. Duhet një ofensivë e madhe diplomatike dhe duhet urgjentisht Parlamenti të miratojë një rezolutë për krimet serbe dhe gjenocidin e ushtruar në Kosovë, për spastrimin etnik etj.

“Qeveria e Kosovës nuk kanë qenë në qëndrimet e duhura gjatë kohës kur janë burgosur ish-krerët e UÇK-së nuk ka pasur asnjë deklaratë për Gjykatën, e cila flet në emër të Kosovës. Shqipëria të akordojë fonde për avokaturën e katër ish-krerëve të UÇK, fond të veçantë nga taksapaguesit.

Unë mendoj se taksapaguesit shqiptarë janë të gatshëm të financojnë çfarëdo shume për të çuar në vend dinjitetin e atyre katër personave. U barazua viktimat me agresorin dhe kjo është e padrejtë", tha ai.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Jo në emrin tonë1"/ Studentët në Prishtinë marshim proteste në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së](#)

[Ballkani nën kërcënimin e Serbisë? Paralajmëron gjenerali amerikan: Ka vende të tjera që përfitojnë](#)

11:20 Rajoni / 2 komente

"Me kokën lart, babë. Gjithmonë", djali i Jakup Krasniqit me mesazh prekës një ditë pas verdiktit

10:20 Rajoni

Cilat janë hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Gjykatës Speciale?

09:00 Rajoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.